



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Elbasan më __. __2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Mbikqyrje e objektit: “Rehabilitimi i pellgut ujëmbledhës përroit të Zaranikës dhe Rikonstruksion i digës dhe shtratit të përroit të Zaranikës (Faza e I-rë Rikonstruksion i shtratit KM-0 +440 – KM -3 + 100)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 79714000-2 - Shërbime të mbikqyrjes

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,611,920 (dymilion e gjashtëqind e njëmbëdhjetëmije e nëntëqind e njëzet) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2025-2026.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Mbikqyrje e objektit: “Rehabilitimi i pellgut ujëmbledhës përroit të Zaranikës dhe Rikonstruksion i digës dhe shtratit të përroit të Zaranikës (Faza e I-rë Rikonstruksion i shtratit KM-0 +440 – KM -3 + 100)”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP 162/2020 "Per prokurimin publik", dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore përgjate tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

Shenim-Kjo pike plotësohet duke paraqitur vërtetimin përkatës të Administratës Tatimore .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifave vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2024, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin:

- Vërtetime të leshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturën tatimore të deklarimit të objektit në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI:

- **N.P - 7** Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
- **N.P - 9** Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI:

- **N.S - 1** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S - 8** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
- **N.S - 18** Punime topogjeodezike

Sipas modelit të leshuar nga institucioni përgjegjës për dënimin e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit si dhe në vendimin Nr. 792 dt. 07.10.2020, i ndryshuar me VKM Nr. 329, dt. 02.06.2021 "PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË POSAÇME TË LICENCIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, NËNKATEGORIVE TË LICENCAVE, PROCEDURAVE PËR DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE REVOKIMIN, SI DHE KUOTIZACIONIT VJETOR TË LICENCAVE PËR NDËRHYRJET NË PASURITË KULTURORE MATERIALE".

Pikat e licensave janë përcaktuar në bazë të zerave të pershkruara në preventivin e projektit.

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administrator i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në listpagesat e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune noteriale
- b) Diplomë

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, si mëposhtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Totograf 1 (një)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjësit e mësipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, dhe VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të percaktuar kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licencat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit si dhe në vendimin Nr. 792 dt. 07.10.2020, i ndryshuar me VKM Nr. 329, dt. 02.06.2021 "PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË POSAÇME TË LICENCIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, NËNKATEGORIVE TË LICENCAVE, PROCEDURAVE PËR DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE REVOKIMIN, SI DHE KUOTIZACIONIT VJETOR TË LICENCAVE PËR NDËRHYRJET NË PASURITË KULTURORE MATERIALE", sa i takon ndalimeve të dypunësimit. **Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori i shoqerise dhe drejtuesit teknike.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT